

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Elite Solutions” shpk

Neni 1 – Emri

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Elite Solutions”** më poshtë do të quhet **“Shoqëria”**.

Neni 2 – Themelimi

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

Neni 3 – Selia

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Elbasan, fshati Shushice, rruga “Fangu Tanushi” ZK 3445, pasuria me nr.117/16 3001.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

Neni 4 - Ortakët

4.1 Ortaket e Shoqërisë janë:

- 1 – Z. David Elezi, i biri i Petrit dhe i Valentina, i dtl. 14.03.1981, lindur ne Belsh dhe banues në Elbasan, lagjja “5 Maj”, rruga “Lef Nosi”, mbajtës i leternjoftimit me nr.036886557 me nr.personal I10314009W i cili zoteron 100% te kapitalit.

Neni 5 - Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ne vlerën 100,000 leke i ndarë në 1 pjesë, me vlerë nominale 100,000 Lekë. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortaku i vetëm themelues.

Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortaku themelues.

5.2 Kuotat, me vendim te Ortakëve, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës se shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 6 – Objekti

6.1 Objekti i Shoqërisë është:

Sherbime konsulence për punësim dhe emigrim në Republikën e Shqipërisë. Sherbime të ndryshme sanitare

Neni 7 – Kohëzgjatja

7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 8 - Kompetencat e Ortakëve

8.1 Ortakët, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

Neni 9 - Administrimi i Shoqërisë

9.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- Z. David Elezi, i biri i Petrit dhe i Valentina, i dtl. 14.03.1981, lindur në Belsh dhe banues në Elbasan, lagjja “5 Maj”, rruga “Lef Nosi”, mbajtës i leternjoftimit me nr.036886557 me nr.personal I10314009W i cili zoteron 100% të kapitalit.

9.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe do të qëndrojë në detyrë për një afat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Administratorët emërohen dhe shkarkohen nga detyra në çdo kohë me vendim të Ortakëve dhe/ose në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 10 - Ligji i Zbatueshëm

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes pranë Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor Tirane.

10.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar sot më datë 01.09.2025, nga:

Ortaku:

Z. David Elezi